



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE

AGJENCIA E LEGALIZIMIT,  
URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË  
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

Nr. 5741 Prot  
Tiranë, më 26.08. 2015

Nr. 5757/Prot  
Tiranë, më 02.08. 2015

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8894 datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive" i ndryshuar, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, referuar në vijim si "MB" ndërmjet Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, referuar në vijim si ALUIZNI dhe Agjencisë së Trajtimit të Kredive, referuar në vijim si ATK, referuar së bashku si "Palë".

#### Neni 1

##### Objekti i Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo MB lidhet me qëllim përcaktimin e mënyrës së shkëmbimit të informacionit midis ALUIZNI-t dhe ATK, që ka të bëjë me detyrimet, që subjekte të caktuar, të cilët kanë aplikuar për legalizim ndërtimi pa leje, mund të kenë ndaj shtetit.

#### Neni 2

##### Procedura e dërgimit të informacionit nga ATK

ATK i dërgon ALUIZNI-t çdo muaj, me shkresë ose me email-in zyrtar të institucionit, listën emërore (Emër Atësi Mbiemër), për jo më shumë se 1000 subjekte, që kanë detyrime ndaj shtetit, së bashku me informacione shtesë në lidhje me të dhënat e gjendjes civile dhe vendbanimit të tyre.

**Neni 3**  
**Procedura e dërgimit të informacionit nga ALUIZNI**

1. ALUIZNI, pasi verifikon listën dhe konstaton se ndonjë nga subjektet ka paraqitur kërkesë për legalizim ndërtimi pa leje, njofton ATK-në për fazën në të cilën ndodhet procesi i legalizimit, duke përcaktuar vendndodhjen dhe detaje të tjera për çdo pasuri të paluajtshme që legalizohet, përfshirë dhe informacion nëse praktika e legalizimit është dërguar për regjistrim në ZVRPP-në përkatëse.

2. Informacioni i mësipërm do të dërgohet brenda periudhës prej 30 ditore nga data e marrjes së listës nga ATK.

**Neni 4**  
**Detyrimet e palëve**

1. Palët marrin përsipër zbatimin e MB-së, duke vënë në dijeni në mënyrë reciproke rastet e moszbatimit të saj nga strukturat e varësisë të tyre. Për këtë qëllim palët angazhohen për ti njohur ato, me përmbajtjen e MB-së.
2. Për ndjekjen e zbatimit të MB-së palët do të caktojnë personat e kontaktit të cilët do të jenë respektivisht, për ALUIZNI-Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit dhe Perpunimit të Informacionit Gjeografik dhe për ATK- Specialisti IT dhe Statistike.

**Neni 5**  
**Hyrja në fuqi dhe ndryshimi**

1. Kjo MB hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve.
2. Cdo ndryshim i MB-së do të jetë në varësi të një aprovimi të shkruar nga të dy palët.

**AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE**

**ANDI COMOLLARI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



**AGJENCIA E LEGALIZIMIT,  
URBANIZMIT DHE INTEGRIMIT TË  
ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE**

**ARTAN LAME**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

